

Udhëzues

Pjesëmarrja e organizatave të shoqërisë civile në procesin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor



Përkrahur nga:



Implementuar nga:



Udhëzues

Pjesëmarrja e organizatave të shoqërisë civile në procesin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor

Parathënie

Ky udhëzues është hartuar nga Organizata Mjedisore “Endemika” në kuadër të projektit “Ngritja e kapaciteteve të Organizatave të Shoqërisë Civile për pjesëmarrje në procesin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor”.

Ky projekt është financuar nga fondet e Bashkimit Evropian në kuadër të programit European Union 4 Kosovo, Projekti “Empower - Engage – Build Ownership”, i përkrahur nga Koalicioni i Organizatave: Balkan Green Foundation (BGF) dhe Instituti për Zhvillimin e Politikave (INDEP).

Është zgjedhur të përgatitet një udhëzues për pjesëmarrjen e organizatave të shoqërisë civile në procesin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor, për faktin se përmes këtij procesi i mundësohet organizatave të shoqërisë civile përfshirja në procesin e vendimmarrjes mjedisore duke u bërë pjesë aktive e vlerësimit për plane dhe programe për sektorë të caktuar zhvillimorë si në nivelin lokal dhe në atë qendror.

VSM është një proces informativ dhe transparent, prandaj njohja e mirë e tij do ti mundësojë organizatave të shoqërisë civile që përmes përfshirjes aktive të japin kontributin e tyre për përmirësimin e planeve dhe programeve por edhe prezantimin e çështjeve mjedisore me interes të përgjithshëm.

Përmbajtja

1. Hyrje
2. Kujt i dedikohet ky udhëzues?
3. Çka është Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM)?
4. Rëndësia e VSM-së
5. Parimet themelore të VSM-së
6. Legjislacioni i BE-së për VSM dhe historiku u tij
7. VSM relacioni me Protokolin e VSM dhe me direktiva tjera të EU
8. Ku zbatohet VSM-ja?
9. Ku dallojnë VSM-ja dhe VNM-ja?
10. Fazat e zbatimit të VSM-së
11. Nivelet dhe format (modelet) e përfshirjes së OJQ në zbatimin e VSM-së
12. Metodatat dhe teknikat në procesin e VSM-së
13. Pse është e rëndësishme pjesëmarrja e OJQ-ve dhe publikut në procesin e VSM-së dhe si ndihmon ajo në adresimin e kërkesave mjedisore?
14. Përfitimet nga VSM-ja
15. Problemet e VSM-së
16. Shembuj të zbatimit të VSM-së
17. Referencat dhe burimet e informacionit

1. Hyrje

Vlerësimi Strategjik Mjedisor është një instrument mbështetës në vendimmarrjen mjedisore, i cili mund të kontribuojë në forcimin e angazhimeve të shoqërisë për zhvillim të qëndrueshëm, menaxhimin efikas të resurseve dhe ekonomisë së gjelbër. Bazuar në legjislacionin përkatës në nivel kombëtarë, evropian dhe ndërkombëtarë, VSM ka për qëllim integrimin e çështjeve mjedisore në zhvillimin e planeve, programeve dhe politikave.

VSM është një proces që synon të sigurojë që efektet e rëndësishme mjedisore që rrjedhin nga politikat, planet dhe programet të jenë të identifikuar, vlerësuara, të zbutura, të komunikuar tek vendimmarrësit, të monitoruara dhe ti japë mundësinë publikut që të përfshihet në proces.

VSM është bërë një instrument i rëndësishëm që ndihmon në arritjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm në planifikimin dhe hartimin e politikave publike.

VSM është një mjet i përgjithshëm i cili mund të përdoret në situata të ndryshme. Mbi të gjitha VSM, kërkon nga autoritetet kombëtare, rajonale dhe lokale për kryerjen e vlerësimit strategjik mjedisor për plane dhe programe të caktuara që ata promovojnë.

Në shumicën e vendeve anëtare të BE-së, tani më janë zhvilluar qasje të ndryshme për kryerjen e vlerësimeve strategjike duke përfshirë edhe vlerësimin mjedisor në nivel lokal, e sidomos në hartimin e planeve lokale për shfrytëzim të tokës, planeve për zhvillim të qëndrueshëm, dhe udhëzimeve për planifikimit rajonal. Këto qasje ekzistuese janë duke u forcuar përmes zbatimit të Direktivës VSM.

Zbatimi i VSM është një proces interaktiv i cili duhet të kryhet së bashku (paralelisht) me zhvillimin e planit ose programit përkatës.

2. Kujt i dedikohet ky udhëzues?

Ky udhëzues është hartuar me qëllim që të përdoret nga organizatat e shoqërisë civile për të nxitur interesimin e tyre për pjesëmarrje në procesin e VSM-së, gjatë hartimit të planeve dhe programeve në përputhje me legjislacionin nacional dhe atë evropian.

Udhëzuesi mundë të përdoret edhe nga organizata tjera qeveritare dhe joqeveritare, duke përfshirë edhe vendimmarrësit, ekspertët, bizneset etj, të cilat dëshirojnë të përdorin VSM për të lehtësuar qasje të integruar në strategjitë e planifikimit dhe të zhvillimit, me qëllim të sjelljes së vendimeve më të qëndrueshme dhe më efikase.

Gjithashtu, udhëzuesi ofron një ndihmë të dobishme edhe për të gjitha organizatat tjera, individëve dhe publikun e gjerë që kërkojnë të rrisin dhe zgjerojnë kapacitetet e tyre për VSM-në, me qëllim që të kontribuojnë në përmirësimin e vendimeve përmes angazhimit dhe pjesëmarrjes aktive në procesin e vendimmarrjes për mjedisin.

Së fundi ky udhëzues mundë të shërbejë edhe si një dokument lehtësues, që do ti mundësojë organizatave të shoqërisë civile që ti identifikojnë mundësitë e tyre për të kontribuar në procesin e vendimmarrjes gjatë zbatimit të VSM-së, apo edhe duke kërkuar që ti zbatojnë të drejtat e tyre për informim mbi proceset dhe dokumentet që ndërlidhen me hartimin e planeve dhe programeve që janë subjekt i VSM-së.

Udhëzimet e përmbledhura në këtë dokument, do ti mundësojnë organizatave të shoqërisë civile përfshirjen e tyre edhe në fazën e zbatimit të planeve dhe programeve përmes monitorimit apo zbatimit të masave lehtësues të propozuara gjatë hartimit.

3. Çka është Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM)?

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM) është një proces sistematik për vlerësimin e pasojave mjedisore të një politike të propozuara, iniciativave të një plani apo programi me qëllim të sigurimit se ato janë përfshirë plotësisht dhe trajtohen në mënyrë të përshtatshme në fazën më të hershme të përshtatshme të vendimmarrjes, në të njëjtin nivel me konsideratat ekonomike dhe sociale.¹

Qëllimi kryesorë i VSM-së është sigurimi i një niveli të lartë të mbrojtjes së mjedisit dhe që ti kontribuoj promovimit të zhvillimit të qëndrueshëm. VSM-ja synon përmirësimin e planit ose programit, duke sugjeruar objektivat apo strategjitë e reja, si dhe duke rishikuar strategjitë e propozuara dhe sugjeruar ato që mund të jenë më të mira në drejtim të mbrojtjes së mjedisit dhe minimizimit dhe parandalimit të ndikimeve dhe rreziqeve në mjedis.

VSM synon të sigurojë shqyrtimin e hershëm të aspekteve mjedisore në vendimet për Planet dhe Programet. VSM është një mjet integruar për të mbështetur qasjet ndër-sektoriale, të cilat janë të nevojshme për të arritur objektivat afatgjata të qëndrueshmërisë.

Gjithashtu, VSM luan një rol përcaktues si lehtësuese në procesin e vendimmarrjes për të siguruar një perspektivë të gjerë se si pjesët e ndryshme mund të vijnë së bashku.

VSM-ja si proces duhet të fillojë në fazat fillestare të procesit të përgatitjes së planit dhe duhet të zhvillohet paralel me planin dhe të integrohet plotësisht në të.

¹ *Sadler and Verheem, 1996*

4. Rëndësia e VSM-së

Ka shumë arsye që e mbështesin rëndësinë e VSM-së, sikurse janë²:

- ✓ Nxiti dhe ndihmon për të kuptuar sfidat e zhvillimit të qëndrueshëm, duke përfshirë një perspektivë të integruar në bërjen e politikave dhe planifikimin e proceseve;
- ✓ Mbështet në mënyrë strategjike vendim-marrjen, duke mundësuar kushte për zhvillim;
- ✓ Lehtëson identifikimin dhe diskutimin e opsioneve të zhvillimit dhe ofron udhëzime për të ndihmuar zhvillimin që i përmbahet parimeve të qëndrueshmërisë;
- ✓ Informon planifikuesit, vendimmarrësit dhe publikun e prekur mbi qëndrueshmërinë e vendimeve strategjike, duke siguruar një proces demokratik të vendimmarrjes dhe duke rritur besueshmërisë e vendimeve;
- ✓ Inkurajon vullnet politik, nxiti ndryshime në mentalitetin dhe krijon një kulturë të vendimmarrjes strategjike.

VSM si një qasje e të menduarit strategjik, ka tri objektiva shumë konkrete:

- ✓ Inkurajon integrimin e mjedisit dhe qëndrueshmërisë (duke përfshirë komponentën biofizik, sociale, institucionale dhe aspektet ekonomike), vendosjen e kushteve që mundësojnë një kornizë të propozimeve të ardhshme të zhvillimit;
- ✓ Është një vlerë e shtuar në procesin e vendimmarrjes, që mundëson për të diskutuar mundësitë dhe rreziqet e opsioneve të zhvillimit dhe duke i kthyer problemet në mundësi;
- ✓ Ndryshon mënyrën e të menduarit dhe krijon një kulturë strategjike në vendimmarrje, promovimin e bashkëpunimit institucional dhe dialogut, duke shmangur konfliktet e mundshme.

Nëpërmjet këtyre objektivave, VSM mund të kontribuojë që³:

² *Partidario, 1999; CSIR, 2000; IAIA, 2002.*

³ *International Association for Impact Assessment 2002, SEA performance, criteria, deemed to be axiomatic of SEA good practices*

- ✓ Të sigurojë një perspektivë strategjike, sistematike dhe të gjerë të ndërlidhjes së çështjet mjedisore në kuadër të një kornize të qëndrueshmërisë;
- ✓ Të identifikoj, zgjedh dhe të diskutoj mundësitë kryesore të zhvillimit drejt vendimeve më të qëndrueshme (duke ndërlidhur çështjet biofizike, sociale, institucionale dhe ekonomike);
- ✓ Të zbulojë mundësi strategjike dhe rreziqet në opsionet (alternativat) në kuadër të analizës;
- ✓ Të lehtësoj shqyrtimin e efekteve kumulative në mjedis;
- ✓ Të sugjeroj programe përcjelljes nëpërmjet menaxhimit strategjik dhe monitorimit;
- ✓ Të sigurojë një proces transparent dhe pjesëmarrës, që angazhon të gjitha palët e interesuara me anë të dialogut dhe të nxisë që vendimet e marra të jenë rezultat i angazhimit të përbashkët.

Një planifikim në të cilin zbatohet VSM-ja është shumë më i kompletuar, më gjithëpërfshirës, më përmbajtësor dhe më objektiv se sa një planifikim që nuk e zbaton VSM. Së këndejmi edhe vendimmarrja në planet ku është zbatuar VSM-ja është shumë më e qëndrueshme.




Figura 1: Veprimet strategjike pa VSM dhe me VSM⁴

⁴ <http://sea.unu.edu>

5. Parimet themelore të VSM-së

Zbatimi i procesit të VSM-së, është i mbështetur mbi disa parime themelore.

Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm, që nënkupton shqyrtimin dhe përfshirjen e aspekteve qenësore të mjedisit në përgatitjen dhe aprovimin e planeve dhe programeve të caktuara dhe me konfirmimin e kushteve për ruajtjen e të mirave materiale, vlerave të kulturës dhe të natyrës, hapësirave, llojlojshmërisë biologjike, llojeve të egra bimore dhe shtazore dhe ekosistemeve autoktone, respektivisht të shfrytëzimit racional të resurseve natyrore, kontribuohet në zhvillimin e qëndrueshëm.




Figura 2: Koncepti i Zhvillimit të Qëndrueshëm

Parimi i integritetit, që kërkon zbatimin e politikave të mbrojtjes së mjedisit të cila realizohet përmes sjelljes së planeve dhe programeve bazohet në përfshirjen e kushteve të mbrojtjes së mjedisit, gjegjësisht ruajtjes dhe shfrytëzimit të qëndrueshëm të resurseve natyrore dhe llojlojshmërisë biologjike në planet dhe programet ndër sektoriale.

Parimi i kujdesit, që nënkupton që çdo aktivitet duhet të zbatohet në atë mënyrë, që para miratimit, të parandalojë apo të zvogëlojë ndikimet negative të planeve dhe programeve të caktuara në mjedis të sigurojë shfrytëzim racional të resurseve natyrore dhe zvogëlojë rrezikun për shëndetin e njeriut dhe të mirave materiale.

Parimi i hierarkisë dhe koordinimit, që në përcakton se vlerësimi i ndikimit të planeve dhe programeve kryhet në nivel qendror për planet ose programet që nxirren në nivelin qendror dhe lokal dhe se në procedurën e VSM-së, të planeve ose programeve, ngritja e shkallës së transparencës në vendimmarrje sigurohet në koordinim të ndërsjellë të organeve dhe organizatave kompetente në procedurën e dhënies së pëlqimit për VSM, përmes konsultimeve, respektivisht njoftimit dhe dhënies së mendimit për ato plane ose programe.

Parimi i informimit publik, i cili zbatohet më qëllim të informimit të publikut për planet ose programet e caktuara dhe për ndikimin e mundshëm të tyre në mjedis dhe më qëllim të sigurimit të transparencës së plotë gjatë procedurës së përgatitjes, nxjerrjes dhe miratimit të planeve ose programeve, para marrjes së vendimit, si dhe pas miratimit të planeve ose programeve, publiku patjetër duhet që të ketë qasje në informata të cilat kanë të bëjnë me ato plane ose programe dhe modifikimin e tyre.




Figura 3. VSM: informim, dialog, zbatim

6. Legjislacioni i BE-së për VSM dhe historiku i tij

Në korrik të vitit 2001, pas rreth 25 vjet të diskutimit, Komisioni Evropian ra dakord për Direktivën e VSM (Direktiva 2001/42 / KE) *“mbi vlerësimin e ndikimeve të planeve dhe programeve të caktuara në mjedis Direktiva e VSM e obligon të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit Evropian që të ketë ratifikojnë atë në ligjin e vendit të tyre”*. Në praktikë, kjo kërkesë është plotësisht operacional në më pak se gjysmën e vendeve të BE-së, mirëpo është duke u përmirësuar me kalimin e kohës.

Direktiva e Vlerësimit Strategjik Mjedisor është një kërkesë e Bashkimit Evropian që kërkon të sigurojë një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit duke integruar konsideratat mjedisore në procesin e përgatitjes së planeve dhe programeve të caktuara.

Qëllimi i Direktivës është *“për të kontribuar në integrimin e konsideratave mjedisore në përgatitjen dhe miratimin e planeve dhe programeve me qëllim të promovimit të zhvillimit e qëndrueshëm, duke siguruar që kjo të bëhet një vlerësim mjedisor i planeve dhe programeve të cilat pritet të kenë efekte të konsiderueshme në mjedis”*.

Para kësaj, disa iniciativa e kanë përshkruar nevojën për Vlerësim Strategjik Mjedisor.

- ✓ 1990 - Komuniteti Evropian Ekonomik lanson propozimin e parë për një Direktivë mbi Vlerësimin Mjedisor të Politikave, Planeve dhe Programeve.
- ✓ 1991 - Konventa e UNECE mbi Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis në kontekst ndërkuftar promovon zbatimin e ndikim mjedisor për politikat, planet dhe programet.
- ✓ 1991 - Komiteti i Asistencës për Zhvillim i OECD miraton në parime thirrjen për një marrëveshje specifike për analizimin dhe monitorimin e ndikimeve mjedisore të programit të ndihmës.

- ✓ 1997 - Këshilli i Bashkimit Evropian miratoi një propozim për një Direktivë të Këshillit mbi vlerësimin e ndikimeve të planeve dhe programeve të caktuara në mjedis,
- ✓ 2001- Këshilli i Bashkimit Evropian miraton Direktivën e Këshillit 2001/42 / EC në 27 qershor për vlerësimin e ndikimeve të planeve dhe programeve të caktuara në mjedis.

7. VSM - Relacioni me Protokolin e VSM dhe me Direktiva tjera të BE

Koncepti i Vlerësimeve Strategjike e ka origjinën nga planifikimi rajonal i përdorimit dhe zhvillimit të tokës në botën e zhvilluar. Në vitin 1981 Departamenti amerikan i Strehimit dhe Zhvillimit Urban publikoi një udhëzues për Vlerësimin e ndikimeve për hapësirat e gjera.

Në Evropë Konventa për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis në kontekst ndërkuftar e ashtuquajtura Konventa ESPOO ka hedhur themelet e para për futjen e Vlerësimit Strategjik Mjedisor në vitin 1991. Në vitin 2003, Konventa ESPOO është plotësuar nga një protokoll mbi Vlerësimin Strategjik Mjedisor.

Protokoli i Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Evropën (UNECE) për Vlerësimin Strategjik Mjedisor është miratuar në Kiev në maj të vitit 2003 dhe më pas është nënshkruar nga 37 shtete dhe nga vendet e Bashkimit Evropian.

Megjithatë, protokoli parasheh që pas nënshkrimit që është vetëm faza e parë e implementimit të protokolit - shtetet anëtare të UNECE duhet të ratifikojë, pranojë, miratojë ose aderojë në protokollin që ajo të hyjë në fuqi. Pas hyrjen në fuqi, çdo shtet anëtar i Kombeve të Bashkuara, mund të aderojë për miratimin e Protokollit.

Sipas protokollit, termi “VSM”, ka një kuptim më të veçantë dhe nënkupton: vlerësimin e mjedisit të mundshëm, duke përfshirë shëndetin, efektet, që përfshijnë përcaktimin e qëllimit të një raporti mjedisor dhe përgatitjen e tij, përfshirja (involvimi) i pjesëmarrjes së publikut dhe konsultimeve si dhe marrja parasysh e raportit mjedisor dhe rezultateve nga pjesëmarrja e publikut dhe konsultimeve në kuadër të një planit ose programit (art. 2, parag. 6).

Kërkesat e Protokollit janë gjerësisht të ngjashme dhe në përputhje me ato të Direktivës VSM. Parimisht të njëjtat lloje të planeve dhe programeve kërkojnë VSM si;

- ✓ raporti mjedisor kërkohet nga Protokoli përfshin informacion të ngjashëm me atë që kërkohet nga Direktiva; dhe
- ✓ ka kërkesa të ngjashme të konsultimit.

Dallimet kryesore në mes të Protokollit të UNECE për VSM dhe Direktivës së VSM-së janë:

- ✓ Protokoli fokusohet më shumë në ndikimet shëndetësore;
- ✓ Protokoli është dokument më i qartë sa i përket pjesëmarrjes së publikut, dhe ka kërkesa më të rrepta të pjesëmarrjes publike;
- ✓ Edhe pse zbatohet vetëm për planet dhe programet, protokoli gjithashtu përmend politikat dhe legjislacionin; dhe
- ✓ Protokoli ka kërkesa më të ndërlikuara rreth ratifikimit, zbatim etj

Implementimi i Direktivës së VSM, ka ndërlidhje edhe me direktiva tjera të BE-së. Një përmbledhje e ketyre ndërlidhjeve është prezantuar në tabelën 1.

Tabela 1: Direktivat mjedisore te BE-së, dhe relacioni i tyre me Direktivën e VSM

Emri i Direktivës	Relacioni me Direktivën e VSM
Direktiva Kornizë e Ujërave (Directive 2000/60/EC)	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Direktiva 2000/60 / EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 23 tetor 2000 kanë themeluar një kornizë për veprimin e komunitetit në fushën e politikës së ujit. Plani i Menaxhimit të Pellgut Lumor (neni 13 WFD) ✓ Direktiva Kornizë e Ujërave dhe Direktiva VSM janë të ngjashme dhe sigurojnë një Vlerësim Mjedisore bë shkallë të gjerë. Megjithatë, ka disa dallimet në mes të elementeve në vlerësimin e mjedisit që mbulojnë e

⁵ http://sea.unu.edu/course/index.html%3Fpage_id=25.html

	në mënyrë specifike tek qasja e pjesëmarrjes së publikut.
Direktiva e Nitrateve (91/676/EEC)	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Direktiva e Nitratet (91/676 / EEC) kërkon veprime në kuadër të programeve për zonat e kërcënuara nga ndotja me nitrate. Këto programe janë të drejtuar kryesisht nga zbatimi i praktikave praktikave të caktuara bujqësore por edhe nga projektet . ✓ Në situata të caktuara, megjithatë, këto veprime programore mund të përcaktojnë kuadrin për miratimin e ardhshëm të zhvillimit të projekteve të tilla si njësitë intensive blegtorale. ✓ Në raste të tilla ato mund të konsiderohen si "programe" brenda kuptimit të Direktivës VSM dhe për këtë arsye duhet të kërkohet zbatimi i vlerësimit mjedisor strategjik. ✓ Në rastet kur ata i referohen ekskluzivisht praktikave bujqësore, e jo projekteve, nuk duhet të kërkohet zbatimi i Direktivës së VSM .
Direktiva Kornizë e Mbeturinave (75/442/EEC, 2006/12/EC)	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Direktiva Kornizë e Mbeturinave (75/442 / EEC, 2006/12 / EC) kërkon nga vendet anëtare hartimin e planeve për menaxhimin e mbeturinave mbeturinave (neni 7). ✓ Zbatueshmëria e Direktivës së VSM varet nga përmbajtja e planit të menaxhimit të mbeturinave. ✓ Nëse plani i menaxhimit të mbeturinave identifikon ose krijon kornizën për dhënien e pëlqimeve për zhvillimin e instalimeve për hedhjen e mbeturinave, atëherë duhet të zbatohen kërkesat e Direktivës së VSM.
Direktiva Kornizë për Cilësi të Ajrit (Directive 96/62/EC)	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Direktiva 96/62 / EC kërkon nga Shtetet Anëtare të përgatisin dhe zbatojnë plane ose programe për të përmirësuar cilësinë e ajrit. ✓ Planet apo programet për arritjen vlerën kufi brenda afatit të caktuar kohor, Neni 8 (3). ✓ Planet ose programet të integruara që mbulojnë të gjithë ndotësit relevant, Neni 8 (4). ✓ Këto Plane dhe programe mund të kërkojnë vlerësimin strategjik mjedisor (VSM), në qoftë se ato vendosin kornizën për zhvillim dhe miratimin e projekteve, prandaj shtetet anëtare përcaktojnë

	nëse ato mund të kenë ndikime të rëndësishme mjedisore.
Direktiva për Zhurmën Mjedisore (Directive 2002/49/EC).	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Direktiva mbi Zhurmën Mjedisore synon që të kërkojë nga autoritetet kompetente në shtetet anëtare të BE për të hartuar harta strategjike të zhurmës në bazë të treguesve të harmonizuar, të informojë publikun rreth ekspozimit të zhurmës dhe efektet e saj, dhe të hartojnë plane veprimi për të adresuar çështjet e zhurmës. (Direktiva 2002/49 / EC Neni 8: planet e veprimit). ✓ Këto plane të veprimit mund të kërkojnë vlerësimin strategjik mjedisor (VSM), në qoftë se ato kanë vendosur kornizën për zhvillimin apo miratimin e projekteve dhe kur shteti anëtarë i BE përcakton që ato mund të kenë ndikime të rëndësishme mjedisore.
Direktiva e Habitave (Directive 92/43/EEC)	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Direktiva 92/43 / EEC synon ngritjen e një rrjeti koherent evropian ekologjik të zonave të veçanta të mbrojtura. ✓ Propozimi i zonave të mbrojtura sipas Direktivës së Habitave nuk ka të ngjarë të kërkojë vlerësim sipas Direktivës së VSM. ✓ Të dy Direktivat zbatohen në mënyrë kumulative për planet dhe programet të cilat kanë ndikime në zona të mbrojtura në pajtim me nenin 6 të Direktivës së Habitave, Neni 3 (2) (b) të Direktivës VSM. ✓ Për këtë arsye, një procedurë e kombinuar mund të kryhet me kusht që të përmbush kërkesat e dy Direktivave. Procedura duhet të përfshijë hapat procedurale të kërkuara nga Direktiva e VSM dhe testimi lidhur me ndikimin në zonat e mbrojtura kërkuara nga Direktiva për Habitatet. ✓ Për Planet e Menaxhimit të Natyres duhet të zbatohet procedura rast pas rastit.
Direktiva për Vlerësim të Ndikimit në Mjedis (Council Directive 85/337/EEC of 27 June 1985, Council Directive 97/11/EC of 3 March	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Një nga kriteret për të kërkuar zbatimin e Direktivës VSM është nëse një plan ose program përcakton kuadrin për miratimin e ardhshëm të zhvillimit të projekteve të listuara në Shtojcat e Direktivës VNM. ✓ Në teori, këto dy Direktivat normalisht kanë një përputhje të zbatueshmërisë ku Direktiva VSM

<p>1997. Directive 2003/35/EC of the European Parliament and of the Council of 26 May 2003)</p>	<p>zbatohet për planeve dhe programeve, ndërsa Direktiva VNM zbatohet për projektet.</p> <p>✓ Megjithatë, këto dy rregulla janë të mundshme ku "objekti", që vlerësohet bie brenda përkufizimit të një "projektit" të përcaktuar në Direktivën e VNM-së dhe përkufizimin e "planeve dhe programeve" nën Direktivës VSM.</p>
---	---

8. Ku zbatohet VSM-ja?

Në kuptimin e saj si një model i të menduarit strategjik, VSM vlen për komponentet strategjike të proceseve vendimmarrëse në:

- ✓ politika publike,
- ✓ plane dhe programe të zhvillimit sektorial,
- ✓ plane dhe programe të zhvillimit territorial dhe
- ✓ projekte të mëdha investuese strukturore që kanë objektiva strategjike afatgjata.




Figure 4: Implementimi i VSM-së

Megjithatë më shumë se një vlerësim i propozimeve në zhvillim, VSM është një instrument i rëndësishëm që ndihmon për tu përballur me sfidat e zhvillimit të krijuara nga:

- ✓ Përshtatja dhe zbutja ndaj ndryshimeve klimatike;
- ✓ Zhdukja e varfërisë dhe kapërcimi i pabarazive sociale dhe rajonale;
- ✓ Rritja dhe mirëmbajtjen e vlerave të biodiversitetit, shërbimeve të ekosistemit dhe mirëqenies së njeriut;

- ✓ Kohezioni territorial dhe social;
- ✓ Promovimi i potencialit të zhvillimit rajonal;
- ✓ Inovacioni dhe diversiteti kulturor i popullsisë;
- ✓ Promovimi i cilësisë së mjedisit, peizazhit dhe trashëgimisë kulturore dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore.



Figura 5. Planet dhe programet sektoriale që kërkojnë VSM

VSM është promovuar gjerësisht nga agjencitë ndërkombëtare të zhvillimit si Banka Botërore (2011), UNEP (2009), OECD (2006).

9. Ku dallojnë VSM-ja dhe VNM-ja

VSM buron nga metodologjia e VNM-së;

- ✓ Metodologji e formalizuar,
- ✓ Vlerësimi i ndikimit të propozimeve konkrete,
- ✓ Mundësi të strukturuar për reagime nga vendimmarrësit.

VSM nuk është VNM:

- ✓ Më e përshtatshme për të analizuar planet dhe programet sektoriale dhe rajonale,
- ✓ E fokusuar në pamje më të gjerë, shqetësimet prioritare dhe tendencat (trendet),
- ✓ Nuk është shumë e detajuar dhe nuk parasheh vlerësime specifike në zonën përkatëse,
- ✓ Instrument plotësues,
- ✓ E integruar vertikalisht.

Dallimet kyçe në mes të VSM dhe VNM janë prezantuar në tabelën 2.

Tabela.2: Dallimet në mes të VSM-së dhe VNM-së

	VSM	VNM
Procesi	Përsëritës	Linear
Zbatimi	Plane dhe Programe	Projeket
Shkalla	Makro (shkallë të gjerë)	Mikro (shkallë të ngushtë)
Ekzaminimi	Në të shumten e rasteve i përcaktuar rast pas rasti	Projektet që kërkojnë VNM zakonisht janë të listuara
Studimi	Shkallë e gjerë e aktiviteteve në një hapësirë të gjerë,	Shkallë më e vogël e aktiviteteve në nivel lokal

	Kombinim i agjendave politike, pjesëmarrësve, diskutimeve dhe vlerësimeve nga ekspertët	Kombinimi i çështjeve që ndërlidhen me zonën përkatëse lokale dhe i teknikave të kontrollit
Pjesëmarrja e publikut	I fokusuar në përfaqësuesit e grupeve specifike dhe autoriteteve relevante	Zakonisht përfshinë publikun e gjerë
Të dhënat bazë	Më pak e detajuar/ Cilësore	Më shumë e detajuar/ sasiore
Alternativat dhe efektet kumulative	Më shumë e theksuar/ integruese	Më pak e theksuar/ specifike
Vlerësimi i nikimeve	Më shumë cilësore (vlerësim nga ekspertët)	Më shumë sasiore (analiza dhe matje)
Konsultimi	Grup më i madh individësh	Grup më i vogël individësh
Rishikimi (kontrolli) i cilësisë	Informata cilësore dhe pjesëmarrje në proces	E fokusuar më shumë në informata cilësore
Vendimmarrja	Krahasimi i alternativave pëballë objektivave politike	Krahasimi përballë normave dhe standardeve
Monitorimi	I fokusuar në implementimin e planit/programit	I fokusuar në matjen e ndikimeve aktuale të projektit përkatës

Ndërsa krahasimet në mes të VSM dhe VNM janë prezantuar në tabelën 3.

Tabela.3: VSM krahasuar me VNM⁶

VSM	VNM
<ul style="list-style-type: none"> ✓ Zhvillohet në fazat e hershme të ciklit të vendimmarrjes. ✓ Proces me shumë faza dhe forma të ndryshme të politikave, planeve dhe programeve. ✓ Me qasje pro-aktive dhe me fokus primar për të zhvilluar propozime, ✓ Shkallë më gjithëpërfshirëse e analizave, (psh. ndërlidhja në mes të çështjeve mjedisore dhe aspekteve ndër-sektoriale). ✓ Konsideron një gamë më të gjerë të alternativave potenciale për zhvillimi, ✓ Jep paralajmërim të hershëm të ndikimeve kumulative. ✓ Me theks në përbushjen e qëllimeve dhe si roje e mbrojtjes së mjedisin. ✓ E fokusuar për të “bërë më të mirën”. 	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Zhvillohet në fazën e fundit të procesit të ciklit të vendimmarrjes. ✓ Procesi i mirë-përcaktuar, me fillim dhe fund të qartë. ✓ Reagon ndaj propozimeve specifike për zhvillim. ✓ E detajuar, analizë e pasojave dhe shkaqeve të ndikimit në mjedis nga komponentat përbërëse të projektit. ✓ Merr në konsideratë sasi të kufizuara të alternativave të fizibilitetit. ✓ Mundësia e kufizuar për adresimin e ndikimeve kumulative të projektit. ✓ Theksi në zbutjen apo minimizimin e ndikimeve në mjedis. ✓ Fokusimi në “të bëhet sa më pak dëm në mjedis”.




Figura 6: VNM + Planifikim = VSM

⁶ Adaptuar nga: ABAZA, H., BISSET, R., SADLER, B. (2004) *Environmental Impact Assessment and Strategic Environmental Assessment: Towards an Integrated Approach*, UNEP

10. Fazat e zbatimit të VSM-së

Ekzaminimi- Procesit të zbatimit të VSM-së, i paraprinë faza ekzaminimit e cila është një fazë ku përcaktohet nëse plani apo programi përkatës duhet ti nënshtohet procedurës së VSM-së. Metoda e determinimit nëse për një plan ose program duhet të zbatohet VSM-ja, është prezantuar në figurën 7.




Figura 7: Procesi i ekzaminimit të VSM-së

Për rastet kur faza e ekzaminimit përcakton që për një Plan apo Program duhet të zbatohet VSM-ja, atëher fillon procesi i zbatimit. Për të qenë më e thjeshtë dhe më lehtë e zbatueshme, VSM-ja, ndahet në disa aktivitete të ndryshme që kryehen nëpër faza të caktuara, përgjatë zhvillimit të planit dhe programit dhe shqyrtimit të opsioneve dhe alternativave. Këto faza janë prezantuar ne figurën 8.




Figura 8: Fazat e VSM-së

Faza A: Konteksti, Studimi bazë - Në këtë fazë autoriteti që harton planin apo programin përkatës duhet të marrë parasysh disponueshmërinë e informacionit bazë dhe të propozojë objektiva dhe tregues për VSM. Ky material është i nevojshëm që në fillim, kur problemet dhe mundësitë janë duke u zhvilluar (Direktiva VSM - Shtojca 1). Autoriteti përkatës vendos për shkallën e raportit mjedisor, dhe çfarë niveli i detajeve duhet ekzaminuar. Në këtë fazë duhet të konsultohen edhe trupat nacional.

Faza B: Alternativat dhe Vlerësimi- Në këtë fazë, duhet të identifikohen alternativat e arsyeshme të planit (Direktiva VSM - Neni 5.1). Autoritetet kanë nevojë për të vlerësuar ndikimet e mundshme në mjedis të planit në zhvillim, dhe alternativat e tij (Direktiva VSM - Neni 5.1). Kur ka efekte të kundërta si rezultat i planit, informacioni duhet të sigurohet se si këto do të reduktohet, parandalohen apo kompensohen (Direktiva VSM - Shtojca 1).

Faza C: Përgatitja e Raportit Mjedisor- Raporti mjedisor është output (produkt) kryesor i procesit të VSM i cili do të paraqesë informacion mbi efektet e draft planit ose programit.

Faza D: Konsultimi- Raporti mjedisor duhet të jetë në dispozicion për konsultim në të njëjtën kohë me draft-planin (SEA Direktiva - Neni 6.2 dhe Shtojcën 1). Pas që përgjigjet e konsultimit janë pranuar, një deklaratë duhet të bëhet në lidhje se si Raporti Mjedisor dhe përgjigjet e konsultimit janë marrë në konsideratë në planin e zhvillim (Direktiva VSM - Neni 8).

Faza E: Monitorimi- Monitorimi i efekteve të rëndësishme mjedisore të zbatimit të planit (Direktiva VSM - Neni 10.1). Kjo lejon efekte të paparashikuara anësore të planit të njihet dhe të trajtohen. Monitorimi gjithashtu mundëson parashikimet e ardhshme të jenë më të saktë dhe jep informacion bazë për planet e ardhshme.

Një përmbledhje e kërkesave që duhet të zbatohet përgjatë procesit të VSM-së, është prezantuar në tabelën vijuese.

Tabela 4 : Kërkesat e Direktivës së VSM-së

Çështjet/Temat	Kërkesa e Direktivës së VSM
<p>Përgatitja e një raporti të VSM-së, në të cilin efektet domethënëse të mundshme në mjedisin e zbatimit të planit ose programit dhe alternativat e arsyeshme duke marrë parasysh objektivat dhe fushëveprimin gjeografik të planit ose programit, janë identifikuar, përshkruar dhe vlerësuar. Informatat që duhet dhënë janë (Neni 7 dhe Aneksi II):</p>	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Raporti do të duhej të përfshijë informata të tilla siç janë përmendur në Aneksin II, që mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme, duke marrë parasysh (Neni 7.3): njohuritë aktuale dhe metodat e vlerësimit; përmbajtjen dhe nivelin e detajeve në plan ose program; fazën e planit ose programit në vendimmarrje dhe fazën e procesit për çështjet e caktuara që vlerësohen më përshtatshëm në nivele të ndryshme në atë proces për ta shmangur dyfishimin e vlerësimit. ✓ një përmbledhje të përmbajtjeve, objektivave kryesore të planit ose programit dhe raportet me planet dhe programet tjera relevante. ✓ aspektet relevante të gjendjes aktuale të mjedisit dhe evolucionit të mundshëm të tij pa zbatimin e planit ose programit. ✓ karakteristikat mjedisore të zonave që mund të preken në mënyrë të konsiderueshme. ✓ çdo problem ekzistues mjedisor, i cili është relevant për planin ose programin, duke përfshirë, në veçanti, ato që lidhen me çdo fushë të një rëndësie të veçantë për mjedisin, siç janë zonat e caktuara në pajtim me Direktivat 79/409/EEC dhe 92/43/EEC. ✓ objektivat për mbrojtjen e mjedisit, të krijuara në nivel kombëtar, ndërkombëtar ose të atij të Komunitetit Evropian, që kanë të bëjnë me planin ose programin dhe mënyrën se si këto objektiva ose konsiderata mjedisore janë marrë parasysh gjatë përgatitjes së saj ✓ efektet e rëndësishme të mundshme në mjedis (duke përfshirë efektet dytësore, kumulative, sinergjike, afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë, të përhershme dhe të përkohshme, pozitive dhe negative dhe sipas nevojës edhe efektet ndërkufitare), në çështjet e tilla si biodiversiteti,

	<p>popullata, shëndeti i njeriut, flora, fauna, toka, uji, ajri, faktorët klimatik, asetet materiale, trashëgimia kulturore dhe natyrore duke përfshirë trashëgiminë arkitekturale dhe arkeologjike, pesizhin dhe raportin në mes të faktorëve të mësipërm.</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ masat e parashikuara për të parandaluar, zvogëluar dhe kompensuar sa më shumë që të ketë mundësi efektin e rëndësishëm negativ në mjedis të zbatimit të planit ose programit. ✓ një përshkrim të arsyeve për përzgjedhjen e alternativave të trajtuara, si dhe përshkrimi i asaj se si është realizuar vlerësimi, duke përfshirë secilën vështirësi - siç janë vështirësitë teknike ose mungesa e ekspertizës - të hasura gjatë përgatitjes së informacionit të kërkuar. ✓ një përshkrim të masave të parashikuara në lidhje me monitorimin. ✓ një përmbledhje jo-teknike e informacionit të dhënë nën titujt e mësipërm.
<p>Procedurat e konsultimit</p>	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Të konsultohen organet konsultative kur të vendoset për fushëveprimin dhe nivelin e detajeve të informatave që duhet të përfshihen në raport (Neni 7.5). ✓ Të sigurohet që organeve konsultative dhe publikut tu jepet mundësia efektive për të shprehur mendimin e tyre mbi dokumentet përkatëse (projekt propozimin e mëhershëm të planit ose programit dhe raportin e tij shoqërues të VSM-së) (neni 8). ✓ Të aranzhohet një debat publik (neni 9). ✓ Të aranzhohet procesi i konsultimit me vendet tjera, në rast se plani ose programi mund të ketë efekte të rëndësishme në mjedisin e atyre vendeve (Neni 10). ✓ Vendimmarrja duhet të ketë parasysh raportin e VSM-së si dhe rezultatet e konsultimeve (neni 14).
<p>Informata mbi vendimin</p>	<p>Kur plani ose programi miratohet, publiku, organet konsultative dhe çdo shtet i konsultuar do të duhej të informohej dhe këto si më poshtë duhet të vihen në dispozicion të këtyre më lartë (Neni 15):</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ si janë janë integruar çështjet mjedisore në plan ose program.

	<ul style="list-style-type: none"> ✓ si janë marrë parasysh mendimet nga autoritetet konsultuese dhe publikut, përfshirë edhe konsultimet e publikut dhe ndonjë pikëpamje si rezultat i konsultimeve ndër shtetërore. ✓ arsyet për zgjedhjen e planit apo programit nga shqyrtimi i alternativave të tjera të arsyeshme. ✓ masat që duhet të ndërmerren për të monitoruar efektet domethënëse mjedisore të zbatimit të planit ose programit.
Monitorimi i efekteve të mundshme mjedisore të zbatimit të planit apo programit (neni 16)	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Monitorimi i efekteve të rëndësishme mjedisore të planit ose programit me qëllim të identifikimit të efekteve të paparashikuara negative në një fazë të hershme për të qenë në gjendje të ndërmarren masat e duhura korrigjuese. ✓ Programi i monitorimit mund të përfshijë edhe masat e përcaktuara për qëllime të tjera.
Sigurimi i cilësisë	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Raportet mjedisore duhet të jenë të një niveli/standardi të mjaftueshme për të përmbushur kërkesat e Direktivës VSM.

11. Nivelet dhe format e përfshirjes së OJQ në zbatimin e VSM-së

Për të arritur pjesëmarrjen e suksesshme të publikut, është thelbësore që të:

- ✓ Të sigurohet qasja në informacion për gjithë periudhën e procesit të VSM-së.
- ✓ Të dëgjohen mendimet e palëve të ndryshme në faza të ndryshme.
- ✓ Të arrihen marrëveshje të përbashkëta.

Secila fazë e procesit ka metoda, mjete dhe instrumente të ndryshme. Në zgjedhjen e metodës, çështjet kryesore që duhet të merren parasysh janë:

- ✓ Natyra dhe numri i akterëve (nivelit arsimor, njohurive teknike, nivelit të ndërgjegjësimit mjedisor, statusit social, etj);
- ✓ Natyra dhe kompleksiteti i planit/programit dhe karakteristikat teknike të informacionit që duhet dhënë palëve të interesuara;
- ✓ Kushtet institucionale dhe mundësitë apo burimet financiare në dispozicion për zbatimin e aktiviteteve.

Më poshtë janë prezantuar modele të ndryshme që mundë të përdoren përgjatë procesit të VSM-së, bazuar në praktikat e vendeve të ndryshme.

Tabela 5: Modele që mundë të përdoren për pjesëmarrjen e publikut në procesin e VSM

Modeli	Përshkrimi
Debatet publike	<ul style="list-style-type: none">• Për të siguruar efikasitetin e kësaj metode, është e nevojshme që paraprakisht të sigurohet informacioni i nevojshëm për shoqërinë civile në lidhje me çështjet që do të diskutohen.• Koha dhe vendi duhet të zgjidhen me kujdes dhe në bazë të rrethanave

	<p>ekzistuese. Kjo i lejon shoqërisë direkt dhe menjëherë të shprehë mendimin e tij, të bëjnë pyetje dhe të marrin përgjigje të menjëhershme.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Natyrisht, debatet publike nuk janë mjetet për marrjen e vendimeve. Qëllimi i tyre është identifikimi i nevojave publike dhe shqetësimet si dhe qasjen e tyre ndaj çështjeve specifike.
<p>Pytësorët dhe intervistat</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Është një tjetër metodë e mbledhjes së informacionit. Kjo metodë mundëson identifikimin e mendimeve të personave, të cilët janë të gatshëm dhe të interesuar për të marrë pjesë në takime. Për këtë qëllim, mundë të përdoren komunikimi përmes telefonit dhe internetit. • Komunikimi telefonik është mënyrë e përshtatshme për të marrë komente nga individët në fjalë. Kontaktet e tilla indirekte nuk kufizojnë personat, dhe ata haptazi diskutojnë të gjitha çështjet me interes për ta. • Audiencia e internetit është më e gjerë dhe kostoja e komunikimit më këtë audiencë është më e ulët. Ueb-faqet mund të përmbajë volum të madh të informacionit, dhe lejojnë marrjen e vëllimit të të madh të komenteve nga numri i madh i njerëzve ndryshe nga komunikimi me telefon. Mirëpo duhet pasur parasysh që një pjesë e shoqërisë nuk ka qasje në internet. • Hulumtimet përmes intervistave dhe pyetësorëve gjithashtu mund të kryhet edhe në formë të shkruar.

<p>Dmonstrimet para publikut/Ditët e hapura për qasje në informata</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Ngjarje që organizohen për qëllime të informimit të shoqërisë. Ngjarje e tilla duhet të mbahen në vende publike. • Personave të interesuar duhet ti jepet mundësia për të marrë pjesë në vende të posaçma që janë në lokacion të përshtatësh dhe që organizohen në kohë të përshtatshme, me qëllim që ti ofrohet informacioni relevant mbi çështjet me interes për ta. • Duhet të merret për bazë edhe fakti që publiku i përgjithshëm më lehtë e percepton informatën vizuale prandaj komunikim me mjete vizuale duhet të merret parasysh. • Përveç kësaj, publikut duhet ti ofrohet edhe mundësia për të diskutuar çështjet edhe me specialistët/ekspertët. • Megjithatë, kjo metodë konsumon më shumë kohë, dhe më shumë energji nga specialistët/ekspertët.
<p>Grupe konsultuese</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Kërkon që të konsultohen grupe të vogla njerëzish, të cilat mund të jenë të plotësuar me përfaqësuesit e OJQ-ve apo specialistë të ndryshëm. Ata kanë më shumë besim nga publiku i gjerë dhe janë më të aftë për të informuar shtresat gjerë të popullsisë ose për të mbledhur informacionin e nevojshëm. • Kjo metodë kursen kohë, sepse kërkon përfshirjen e një numri më të vogël të personave, dhe gjithashtu është një metodë që në mënyrë të konsiderueshme e lehtëson arritjen e konsensusit.

Niveli i përfshirjes së organizatave të shoqërisë civile në procesin e vendimmarrjes gjatë Vlerësimit Strategjik Mjedisor mundë të jetë në shkallë të ultë apo të lartë varësisht nga format e involvimit të tyre në proces. Në figurën vijuese janë prezantuar nivelet e pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje në procesin e vlerësimit mjedisor varësisht nga modelet që zbatohen.




Figure 9: Nivelet e pjesëmarrjes së publikut në kuadër të procesit të vlerësimit mjedisor⁷

Direktiva e VSM-së, kërkon implementimin e kërkesave për konsultime (tabela 6).

⁷ *Awakening Participation: Building Capacity for Public Participation In Environmental Decision making, The Regional Environmental Centre, Szentendre, December 1996*

Table 6. Përmbledhje e kërkesave për konsultime në kuadër të Direktivës së VSM-së⁸

Hapat e VSM-së	Kërkesat për konsultimet që kërkojnë në nivelin nacional	Kërkesa shtesë në situatat e kontesteve ndërkuftare
Determinimi nëse plani ose programi kërkon zbatimin e VSM-së	Konsultimi i trupave/autoriteteve nëse kërkohet zbatimi i ekzaminimit. Ofrimi i informatave relevante për publikun	Jo
Vendimi për studimin bazë dhe nivelin e vlerësimit të detajuar	Konsultimi i trupave/autoriteteve konsultative	JO
Raporti mjedisor dhe drafti i planit ose programit	Ofrimi i informatave për publikun. Konsultimi i trupave/autoriteteve konsultative	Konsultimi i autoriteteve mjedisore në vendet anëtare që mundë të ndikohen nga plani ose programi përkatës Konsultimi i publikut në vendet anëtare që mundë të ndikohen nga plani ose programi
Gjatë përgaditjes së planit ose programit	Të merret parasysh Raporti mjedisor dhe të gjeturat/opinionet e shprehura si dhe të prezantohet gjendja	Të merren parasysh rezultatet e konsultimeve në rastet e kontesteve ndërkuftare
Adaptimi i planeve dhe programeve, gjendja mjedisore, masat në lidhje me monitorimin	Të ofrohet informata te trupat/autoritetet konsultative. Të ofrohet informata te publiku	Të ofrohet informata te shtetet anëtare të konsultuara

⁸ Adaptuar nga: European Commission guidance, paragraph 7.2.

12. Metodatat dhe teknikat në procesin e VSM-së

Ekzistojnë metoda dhe teknika të ndryshme të cilat mund të përdoren për të realizuar vlerësime, analiza dhe studime përkatëse në kuadër të procesit të VSM-së. Një përmbledhje e metodave më të shpeshta dhe përdorimi i tyre është prezantuar në tabelën vijuese.

Table 7: Metodatat dhe teknikat e përdorshme në procesin e VSM-së⁹

Metoda	Përdorimet
Punëtori/Konsultime/Panеле	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Për të mbledhur njohuri/informata. ✓ Për të informuar për vendimin e ardhshëm dhe efektet e mundshme mjedisore Për të marrë reagime nga ekspertët dhe publiku. ✓ Për seanca të ideve.
Hartat e Mbulshmërisë & GIS	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Për të identifikuar nevojat, problemet dhe qëllimet e planit apo programit. ✓ Për të mbivendosur ndikimet në pranues ose burime me qëllim të përcaktimit të ndikimeve që mund të jenë të rëndësishme.
Matrica e ndikimeve të ndërsjella (kryqëzuara)	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Për të parashikuar ndikimet e planeve dhe programeve në objektiva mjedisore.
MCA (Analizat shumë-kriterëshe) Alternativat	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Për të vlerësuar ndikimet mjedisore nga alternativat të ndryshme. ✓ Për të përcaktuar se cilat alternative duhet të ekzaminohen. ✓ Për të përcaktuar kufijtë dhe targetet.
Evalumi	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Evaluimi i pasojave të ndryshme mjedisore.
Modelimi	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Adresimimi i marrëdhëniesve në mes të shkaqeve dhe ndikimeve për të marrë

⁹ Adaptuar nga: "Practical guidance on applying European Directive 2001/42/EC "on the assessment of the effects of certain plans and programmes on the environment", (2007) www.odpm.gov.uk

	rezultate sasiore. Përcaktimi i qartë i kufijëve gjeografikë dhe i afateve.
Analiza e trendit	✓ Adresimi i efekteve kumulative afatgjate dhe identifikimi i problemeve.
Opinione ekspertësh	✓ Mundë të përdoret pjesërisht kur metodat tjera nuk janë të përdorshme e veçanërisht në vlerësimin e efekteve kumulative.
CBA (Cost Benefit Analiza)	✓ Ofron një kornizë institucionale për identifikimin, kuantifikimin dhe krahasimin e kostos dhe përfitimeve nga planet dhe programet.
Lista e Kontrollit	✓ Ofron një kornizë për autorët e raporteve/dokumenteve me qëllim që të mos harrohen gjërat/pikat e rëndësishme.
Follow-up (Përcjellja e zbatimit të rezultateve)	✓ Përcjellës se në çfarë drejtimi është duke shkuar përbushja e rezultateve.
Pytësor dhe intervista	<ul style="list-style-type: none"> ✓ E përdorshme për të mbledhur nje gamë më të gjerë të informatave për veprime dhe pranues të ndryshëm. ✓ E nevojshme për të adresuar efektet kumulative. ✓ Intervistat me persona që kanë njohuri apo grupe koncesuale që janë të përfshirë në aktivitete mundë të ndihmojë për të identifikuar efektet kumulative në zonën përkatëse.

Metodat e prezantuara më lartë dhe metoda tjera, janë promovuar dhe rekomandohet të përdoren edhe nga organizata të rëndësishme ndërkombëtare në fushën e mjedisit sikurse janë OECD dhe UNEP.

Në tabelën keni një listë më të zgjeruar të këtyre metodave.

Tabela 8: Metodatat në VSM sipas OECD & UNEP

Metodat	OECD 2006	UNEP 2009
Grup ekspertësh	✓	✓
Teknikat e pjesëmarrjes për Vlerësimin	✓	
Analiza e palëve të interesit dhe planifikimi	✓	✓
SWOT Analiza	✓	
Korniza e qëndrueshmërisë dhe treguesit		✓
Analiza e rrjeteve	✓	
Analiza e hallkave të shkaqeve (CCA)		✓
Root Cause Analysis (RCA)/Analiza e Origjinës së shkakut		✓
Analiza e trendit		✓
Zhvillimi i skenarëve	✓	✓
Pytësorët për analiza sociale dhe ekonomike	✓	
Pytësorët për analizaën e ekonomive familjare		✓
Pytësorët e opinionëve për Identifikimin e prioritetëve	✓	
Grupet e fokusuar	✓	✓
Zhvillimi i proceseve konsensuale	✓	
Analiza e Kost-Benefitit, Analizat e ndjeshmërisë dhe Analizat shumë-kriterëshe	✓	
Sistemet Gjeografike të Informimit (GIS)	✓	
Hartat e mbulueshmërisë	✓	
Analiza e përdorimit të tokave	✓	
Analiza e modelimeve	✓	
Analiza e ndjeshmërisë	✓	
Vlerësimi i kualitetit të jetës	✓	
Vlerësimi i kompatibilitetit	✓	
Analiza e kapaciteteve mbështetëse	✓	
Analiza/Vlerësimi i rrezikut	✓	

Për të zgjeruar njohuritë tuaja rreth metodave që zbatohen në procesin e VSM-se dhe mënyrat e përdorimit dhe aplikimit të tyre mundë përdorni edhe udhëzues tjerë. Një listë e këtyre udhëzuesve dhe burimet në internet ku mundë të gjenden ato janë prezantuar në tabelën 9.

Tabela 9: Burime te informimit/udhëzues per metodologjinë e VSM

Burimi	Faqja e internetit
Komisioni Evropian (2013). Udhëzime mbi integrimin e ndryshimeve klimatike dhe biodiversitetit në vlerësimin strategjik mjedisor.	http://ec.europa.eu/environme nt/eia/sea-support.htm
UNEP (2014). Integrimi i shërbimeve të ekosistemit në vlerësimin strategjik mjedisor: Udhëzues për praktikuesit.	http://www.proecoserv.org/information-hub-test/guideline.html
Partidario, M (2012). Vlerësimi Strategjik Mjedisor-Udhëzues i praktikave më të mira: Udhëzime metodologjike për të menduarit strategjik në VSM. Agjencia e Mjedisit e Portugalisë dhe REDES Energéticas Nacionais.	https://www.iaia.org/publicdocuments/special-publications/SEA%20Guidance%20Portugal.pdf
Vlerësimi Strategjik Mjedisor-Burim i hapur edukativ. Universiteti i Kombeve të Bashkuara dhe Universiteti i Oxford Brookes	http://sea.unu.edu/index.html
Ahmed, K. dhe Sánchez-Triana, E. (Eds) (2008)Vlerësimi strategjik mjedisor për Politika.Banka Botërore, Washington D.C	http://siteresources.worldbank.org/INTRANETENVIRONMENT/1705772-1210788188539/21819527/SEA FOR POLICIES.pdf
OECD (2006). Aplikimi i Vlerësimit Strategjik Mjedisor. Udhëzim për praktika të mira për zhvillimin e bashkëpunimit. Udhëzimet dhe seritë e referencës së DAC	http://www.oecd.org/dac/environment-development/37353858.pdf

<p>Abaza, H., Bisset, R., Sadler, B. (2004) Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis dhe Vlerësimi Strategjik Mjedisor: Drejt një qasjeje të integruar. UNEP</p>	<p>http://www.unep.ch/etu/publications/textONUBr.pdf</p>
<p>ODPM (2005) Udhëzues praktik për Direktivën e Vlerësimit Strategjik Mjedisor. Departamenti Ekzekutiv i Skocisë Kuvendi i Uellsit për mjedis, Irlandë Veriore.</p>	<p>http://www.doeni.gov.uk/niea/bm_sea_practicalguide.pdf</p>

13. Pse është e rëndësishme pjesëmarrja e OSHC-ve në procesin e VSM-së dhe si ndihmon ajo në adresimin e kërkesave mjedisore?

VSM-ja është mjet për përmirësimin e cilësisë së përgjithshme të planifikimit dhe programimit të veprimeve të ardhshme, në atë që ka të bëjë me perspektivën e saj mjedisore. Duke vepruar kështu, kjo mundëson kuptimin dhe programimin më të mirë të të gjitha aktiviteteve mjedisore, duke lehtësuar një perspektivë të integruar të planifikimit të qëndrueshëm hapësinor. Këto aktivitete mund të jenë të ndryshme, por është e rekomandueshme që ndryshimet klimatike dhe biodiversiteti të jenë dy nga komponentet e forta të praktikës së VSM-së.

Pasojat e para të ndryshimeve klimatike tashmë janë vërejtur në Evropë dhe në mbarë botën, me ndikimet që parashikohen të intensifikohen në vitet në vijim, duke rritur gjasat e fatkeqësive natyrore që lidhen me motin. Menaxhimi i rrezikut nga fatkeqësitë po bëhet aspekt qendror që merret parasysh në planifikimin hapësinor, si dhe efektet në komunitetet, duke përfshirë pronën dhe rentabilitetin, pritet që të rritet në dekadat e ardhshme, për shkak të ndryshimit të klimës. Prandaj, adaptimi ndaj ndryshimeve klimatike dhe masat për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë mund të konsiderohet si vendimtare për të përballuar ndikimet e ardhshme negative të rreziqeve natyrore dhe lehtësimin e rreziqeve eventuale.

Duke adresuar politikë-bërjen dhe të menduarit strategjik nga fazat e hershme të tij, VSM-ja mund të luajë rol të rëndësishëm në forcimin e iniciativave e integritimit mjedisor, duke vërë theksin në zhvillimin e qëndrueshëm: përcaktimin e prioriteteve që nuk do ta rrezikojnë të ardhmen dhe janë të bazuara në një ekuilibër të qartë në mes të mjedisit, shoqërisë dhe kornizave ekonomike.

Përgjigjet për ndryshimin e klimës janë të strukturuar zakonisht në dy sferat kryesore të punës, që duhet të merren parasysh dhe integrohen përmes VSM-së:

- Masat lehtësuese - masat që bëjnë shmangien, zvogëlimin, sanimin apo kompensimin për ndikime të domethënëse negative të një veprimi strategjik në mjedis.
- Adaptimi - është proces, ose grup i iniciativave dhe masave, për të reduktuar ndjeshmërinë e sistemeve natyrore dhe njerëzore kundër efekteve të tanishme apo të pritshme të ndryshimeve klimatike. Adaptimi gjithashtu mund të paramendohet si të mësuarit me atë se si të jetojmë me pasojat e ndryshimeve klimatike.

Planifikimi hapësinor mund të ketë efekt pozitiv në rritjen e lidhjeve reciproke në mes adaptimit ndaj ndryshimeve klimatike dhe aktiviteteve të propozuara lehtësuese: përshtatja e masave të caktuara ka për shembull dobi lehtësuese. Një nga rolet e VSM-së është kërkimi për adresimin konflikteve dhe sinergjive të mundshme në mes këtyre masave dhe shmangien e 'keq adaptimit' (p.sh., masat të cilat kërkojnë të përmirësojnë përshtatjen ndaj rreziqeve natyrore në fakt mund të rrisin cenueshmërinë). Udhëzuesi i BE-së për këtë çështje propozon që VSM-ja duhet të bëjë një "vlerësim gjithëpërfshirës të lidhjeve mes lehtësimit të ndryshimeve klimatike, përshtatjen dhe çështje të tjera mjedisore dhe problemeve politike, për të iu shmangur rrezikut të sinergjisë negative dhe politikave jo konsistente; si dhe mundësitë e humbura për eksplorimin dhe promovimin e sinergjive pozitive; dhe alokimi nën-optimal i burimeve dhe reagimeve politike."

Një proces i mirë dhe cilësor i Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM) informon planifikuesit, vendimmarrësit dhe publikun e prekur për qëndrueshmërinë e vendimeve strategjike, lehtëson kërkimin për alternativa më të mirë dhe siguron proces të vendimmarrjes demokratike.

Kjo rrit kredibilitetin e vendimeve duke i drejtuar ato drejt rritjes së efektivitetet duke kursyer në kosto dhe në kohë dhe për të bërë vlerësimin mjedisor në kuadër të projektit. Kriteret e përformacës për të realizuar një proces të mirë dhe cilësor të VSM-së, janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 10: Kriteret e përformacës për Vlerësimin Strategjik Mjedisor¹⁰

Kriteri	Përshkrimi
Është e integruar	<ul style="list-style-type: none"> • Siguron një vlerësim të duhur mjedisor për të gjitha vendimet strategjike relevante për arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm. • Adreson ndërlihdjet në aspektin biofizik, shoqëror dhe ekonomik. • Është i shtresuar në politikat e sektorëve përkatës dhe rajonet (ndërkufitare) dhe, kur është e përshtatshme, në projektet e VNM-të dhe vendimmarrje.
Është e udhëhequr nga qëndrueshmërisë	<ul style="list-style-type: none"> • Lehtëson identifikimin e mundësive zhvillimore dhe propozimeve alternative që janë më të qëndrueshme.
Është e fokusuar	<ul style="list-style-type: none"> • Ofron informata të mjaftueshme, të besueshme dhe të dobishëm për planifikimin e zhvillimit dhe vendimmarrjen. • Përqendrohet në çështjet kyçe të zhvillimit të qëndrueshëm. • Është përshtatur me karakteristikat e procesit të vendimmarrjes. • Është kosto dhe kohë efektive.
Është e përgjegjshme	<ul style="list-style-type: none"> • Është përgjegjësi e agjencive kryesore për marrjen e vendimeve strategjik. • Është kryer me profesionalizëm, saktësi, drejtësi, paanësi dhe ekuilibër.

¹⁰ IAIA 2002, *Strategic Environmental Assessment Performance Criteria*

	<ul style="list-style-type: none"> • Është subjekt i kontrolleve dhe verifikimit të pavarur. • Dokumenton dhe justifikon mënyrën se si janë marrë në konsideratë çështjet e qëndrueshmërisë në vendimmarrje.
Është pjesëmarrëse	<ul style="list-style-type: none"> • Informon dhe përfshin organet qeveritare dhe publike të interesuara dhe të prekura në të gjithë procesin e vendimmarrjes. • Në mënyrë eksplicite adreson inputet dhe shqetësimet e tyre në dokumentimin dhe vendimmarrjen. • Ka kërkesa të qarta, lehtë të kuptueshme dhe siguron qasje të mjaftueshme në të gjitha informatat relevante.
Është ri-përsëritëse	<ul style="list-style-type: none"> • Siguron disponueshmërinë e rezultateve të vlerësimit në fillim për të ndikuar në procesin e vendimmarrjes dhe për të frymëzuar planifikimin e ardhshëm. • Ofron informata të mjaftueshme mbi ndikimet aktuale të zbatimit të një vendimi strategjik, për të gjykuar nëse ky vendim duhet të ndryshohet dhe për të siguruar një bazë për vendimet e ardhshme.

14. Përfitimet nga VSM-ja

Përfitimet kryesore që arrihen nga zbatimi i VSM-së janë:

- ✓ Promovon vendimmarrjen e integruar mjedisore dhe pjesëmarrjen e publikut në hartimin e politikave mjedisore.
- ✓ Forcon rolin e autoriteteve mjedisore përmes pjesëmarrjes së tyre.
- ✓ Përmirëson bashkëpunimin midis autoritetet të ndryshme (planifikimi, mjedisit dhe shëndetit).
- ✓ Proces bashkëpunimi mes shkencëtarëve dhe vendimmarrësve.
- ✓ Mundëson qasjen e shumë palëve të interesuara nëpërmjet konsultimit publik.
- ✓ E rritë transparencës në vendimmarrje, për shkak të përfshirjes së të gjitha niveleve të shoqërisë.
- ✓ Lehtëson projektimin e planeve dhe programeve të qëndrueshme mjedisore dhe bënë monitorimin e efekteve të tyre.
- ✓ Ofron për shqyrtimin e një gamë më të gjerë të alternativave, krahasuar me mundësitë që ofrohen në kuadër të një projekti të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis.
- ✓ Merr në konsideratë efektet kumulative, ndryshimet globale dhe alternativat në fazën e hershme të zhvillimeve.
- ✓ Forcon dhe riorganizon projektet e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis duke identifikuar paraprakisht ndikimet e mundshme, kërkesat për informata dhe duke reduktuar kohën dhe përpjekje për konsultime.
- ✓ Përmirëson qeverisjen e mirë dhe besimit tek publiku.
- ✓ Më pak masa zbutëse për shkak të përfshirjes së hershme të konsideratave mjedisore në plane dhe programe.
- ✓ Kontribuon për përmirësimin e përputhshmërisë me kërkesat e fushave tjera specifike të politikave mjedisore.
- ✓ Lehtëson fondeve të bashkë-financimit nga BE.

15. Problemet dhe sfidat e VSM-së

Problemet kryesore që paraqiten gjatë implementimit të VSM-së, janë kryesisht të aspekteve teknike dhe procedurale. Ndër problemet më të zakonshme janë¹¹:

- ✓ VSM përgjithësisht mbulon një zonë të madhe (gjerë) - nganjëherë disa vende - dhe një numër të madh të alternativave. Kjo e bën mbledhjen dhe analizimin e të dhënave shumë komplekse.
- ✓ VSM është subjekt i niveleve më të larta të pasigurisë krahasuar me projektet e VNM. Pasiguri kjo në kontestin e kushteve mjedisore, ekonomike dhe sociale dhe zhvillimeve tjera të mundshme si rezultat i zbatimit të planeve dhe programeve dhe i zhvillimit të teknologjive të ardhmen.
- ✓ VSM shpesh duhet të përballen me informacion të kufizuar. Të dhënat mjedisore mbledhura në vende të ndryshme janë shpesh jo kompaktibile me gjendjen aktuale apo janë të kufizuara.
- ✓ VSM duhet të merre informacion në nivele të ndryshme për dallim nga projektet e VNM.
- ✓ VSM në nivel kombëtarë duhet të përqendrohet në shqetësimet që janë në nivel kombëtare dhe kjo mundë të ndikojë që të shpërfillen shqetësimet që janë të rëndësishme në nivel lokal, por të cilat nuk ndikojnë në vendimmarrjen e nivelit kombëtar.
- ✓ VSM është një veprim strategjik që mund të mos ketë asnjë fazë formale të autorizuar. Për këtë ajo transformohet në mënyrë të çrregullt përmes implementimit. Kjo mundë të jetë edhe çështje e konfidencialitetit. Vendimmarrësit po ashtu mund të jenë të ndikuar edhe nga faktin që VSM nuk e merr përsipër procesin e vendimmarrjes. Pra, VSM është pak a shumë në thelb një proces politik.
- ✓ Koncepti i VSM, i cili pjesërisht është i udhëhequr drejt qëndrueshmërisë së vlerësimeve mjedisore ende nuk është pranuar

¹¹ <http://sea.unu.edu/>

politikisht. Në shumë vende dominon ende qasja tradicionale në politikëbërje, ku theksi vihet më shumë në çështje që dominojnë në politikat globale sikurse është mirëqenia ekonomike (psh GDP), përpara aspekteve që kanë të bëjnë me cilësinë e përgjithshme të jetës, dhe kjo e pengon përfshirjen e kriterëve dhe synimeve të qëndrueshmërisë, duke ndikuar dukshëm në zbatimin e konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm.

Sfida të tjera që ndërlidhen me procesin e VSM-së përfshijnë edhe:

- ✓ Mungesa e informacionit në lidhje me natyrën e zhvillimeve të ardhshme dhe paqartësitë e ndryshme.
- ✓ Vështirësitë në përcaktimin e rolit të duhur të pjesëmarrësve publik dhe për të siguruar përfshirjen efektive.
- ✓ Koordinimi dhe integrimi i vlerësimit strategjik me proceset e vlerësimit në nivele të tjera.
- ✓ Konflikti në mes të vlerësimit të integruar dhe fragmentimit burokratike.
- ✓ Mungesa e standardeve dhe normave në planifikim dhe në modelet e politikë bërjes.
- ✓ Rezistenca për integrimin e vlerësimit strategjik në vendimmarrjen kryesore.
- ✓ Planet dhe Programet nuk kanë kufij të qartë. Ato mund të ketë rezultate të padëshiruara dhe të paparashikueshme.
- ✓ Pasiguria e madhe dhe kompleksiteti analitikë.
- ✓ Afatet kohor gjatë së cilave kërkohen analizat e nevojshme janë të pasigurta.

16. Shembuj të zbatimit të VSM-së

Në tabelën 11 janë prezantuar disa shembuj të zbatimit të VSM-së në vendet e Ballkanit Perëndimorë. Shembujt janë marrë nga zbatimi i Planeve dhe Programeve në sektorë të ndryshëm zhvillimorë si Energjetikë, Transport, Planifikim Hapësinorë, etj, si dhe në nivele të ndryshme si ai lokal, nacional dhe regional.

Tabela 11: Shembuj të raporteve dhe studimeve të VSM-së

Emri i studimit/raportit	Linku në internet i dokumentit
Vlerësimit Strategjik mjedisor dhe social për TC Kosova C	http://www-wds.worldbank.org/external/default/WDSContentServer/WDSP/IB/2008/07/16/000333038_20080716012909/Rendered/PDF/E13670VOL130Box327408B.pdf
Menaxhimi i Integruar i Resurseve Ujore dhe Vlerësimi Strategjik Mjedisor, së bashku për mbrojtjen e klimës	http://api.commissiemer.nl/docs/cms/16%20%20IWRM%20and%20SEA.pdf
Implementimi i Direktivës së VSM në Maqedoni	http://www.justiceandenvironment.org/files/file/2012/SEA%20case%20study%20Macedonia.pdf
Vlerësimi Startegjik Mjedisor për Planin Zhvillimorë të Komunës së Hanit të Elezit	https://kk.rks.gov.net/hanielezit/getattachment/4417fe87-c0df-4dcb-9990-1099cef36efb/SEA-Hani-i-Elezit.aspx
Raport për Vlerësimin Strategjik Mjedisor për zhvillimet në sektorin e energjisë për Serbinë deri në vitin 2025 dhe projeksionet deri në 2030.	http://www.moew.government.bg/files/file/Industry/SEA/Energy Strategy Serbia/SPU SE engl fin.pdf
Vlerësimi Strategjik Mjedisore për Hidrocentralet në rrjedhen e lumit Mekong	http://www.mrcmekong.org/assets/Publications/Consultations/SEA-Hydropower/SEA-Main-Final-Report.pdf
Studimi për Vlerësimin Strategjik Mjedisore për	https://www.google.com/url?sa=t&rct=j&q=&esrc=s&source=web&cd=2&cad=rja&uact=8&ved=0ah

Startegjine e zhvillimit të sektorit të transportit në Kroaci	UKEwjA Pf5qpbMAhUCEJoKHU0sDewQFggmMAE &url=https%3A%2F%2Fwww.energy-community.org%2Fpls%2Fportal%2Fdocs%2F36236.PDF&usg=AFQjCNGXymt3SqBZhZKtkEuq_OWID0vZyA
Një qasje sistematike për efektivitetin e VSM-së	http://api.commissiemer.nl/docs/mer/diversen/systems_approach_to_sea_effectiveness_def.pdf
Vlerësimi Strategjik Mjedisor për Planin Hapësinorë të Parkut Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”	http://ammk-rks.net/repository/docs/VSM_per_PHPKBN_1014_ang.pdf
Vlerësimi i Shërbimit të Ekosistemeve dhe mësimet nga Vlerësimi Strategjik Mjedisor nga disa shembuj	http://api.commissiemer.nl/docs/mer/diversen/valuation.pdf
Vlerësimi Strategjik Mjedisor për planifikimet në sektorin e Hidroenergjisë	http://cmsdata.iucn.org/downloads/niap_sea_guidance_hydropower.pdf
Raporti i Vlerësimit Strategjik Mjedisorë për programin e bashkëpunimit inter-regjional 2014-2020	https://www.portugal2020.pt/Portal2020/Media/Default/Docs/Programas%20Operacionais/RELATORIOS%20AAE/RELAT%C3%93RIO%20FINAL%20Avalia%C3%A7%C3%A3o%20Ambiental%20Estimativa%20Final.pdf
Aplikimi i Vlerësimit Strategjik Mjedisor, një udhëzues praktik për zhvillimin e bashkëpunimeve	http://www.oecd.org/environment/environment-development/37353858.pdf
Studimi për Vlerësimin Strategjik Mjedisor për programin e bashkëpunimit Greqi-Bullgari 2014-2020	http://greece-bulgaria.eu/images/stories/newsfiles/04092014/news04092014a2.pdf
Udhëzime praktike për vlerësimin strategjik mjedisor të planeve dhe programeve	https://www.naturvardsverket.se/Documents/publikationer/978-91-620-6383-2.pdf
Raporti për Vlerësimin Strategjik Mjedisor të Planit Hapësinorë dhe vlerësimi i qëndrueshmërisë	http://www.islesproject.eu/wp-content/uploads/2015/01/Environmental-Report_submission-version.pdf
VSM-ja dhe biokarburantet	http://api.commissiemer.nl/docs/cms/gtz_factsheet_seabiofuel_final.pdf

Raporti i VSM-së, për Programin e bashkëpunimit ndër-kufitarë Itali-Shqipëri-Mali i zi	http://www.regione.puglia.it/index.php?page=delibere&id=15237&opz=downfile&fs_id=19665
Raporti i VSM-së, për Strategjinë e Menaxhimit të Ujërave të Serbisë	http://www.moew.government.bg/files/file/Industry/SEA/WaterStrSerbia/SEA_ENG.pdf
Efektiviteti i procedurave të VNM-së, dhe VSM-së në Maqedoni	http://www.zeleni.org.mk/uploads/media/Enforcement of SEA and EIA Procedures in Macedonia.pdf
Raporti i VSM-së, për Strategjinë e Energjisë së Malit të zi	http://sites3.iwlearn3.webfactional.com/lss-new/joint-database/draft-strategic-environmental-assessment-report-sea-of-the-montenegro-draft-energy-strategy/sea_of_montenegro_draft_energy_strategy_final_report_7_sep_07.pdf mali i zi/at download/file
Raporti i VSM-së, për Strategjinë Zhvillimore të Transportit në Slloveni	http://www.mzi.gov.si/fileadmin/mzi.gov.si/page/uploads/DMZ/OP_strategija_prirocnik_julij_CPVO_ang.pdf
Raporti i VSM-së, për programin e bashkëpunimit për Evropën Qëndrore 2007-2013	http://www.central2013.eu/fileadmin/user_upload/Downloads/Document Centre/OP_Resources/Central_Europe_SEA_Rep_Final.pdf

17. Referencat dhe burimet e informimit

1. ABAZA, H., BISSET, R., SADLER, B. (2004). *Environmental Impact Assessment and Strategic Environmental Assessment: Towards an Integrated Approach, UNEP.*
2. Agência Portuguesa do Ambiente (2007). *Guia de boas práticas para a Avaliação Ambiental Estratégica: Orientações Metodológicas, Lisbon, Direcção-Geral do Ordenamento do Território e Desenvolvimento Urbano.*
3. ANDRÉ, Pierre et al (2006). *Public participation: international best practice principles, Publikim i Veçantë, Seria nr. 4, Fargo, USA, IAIA .*
4. BOND, A., MORRISON-SAUNDERS, A., STOEGLEHNER, G. (2013). *Sustainability Assessment Pluralism: Practice and Progress, Routledge.*
5. BRAGAGNOLO, C., GENELETTI, D., FISCHER, T.B. (2012). *Impact Assessment and Project Appraisal 30 (2).*
6. CALTHORPE, Peter (2010). *Urbanism in the age of climate change, Washington, Revista Island.*
7. COOPER, L. M. (2004). *Guidelines for Cumulative Effects Assessment in SEA of Plans, EPMG Occasional Paper 04/LMC/CEA.*
8. European Commision (2013). *Guidance on Integrating Climate Change and Biodiversity into Strategic Environmental Assessment.*
9. European Commision (2003). *Implementation of Directive 2001/42 on the Assessment of the effects of certain plans and programmes of the environment.*

10. GENELETTI, D. (2013). *Strategic Environmental Assessment: General principles*.
11. GEHL, Jan (2010). *Cities for people, Washington/Covelo/Londwr, Island Press*.
12. International Association for Strategic Assessment (2002). *Strategic Environmental Assessment: Performance Criteria, IAIA*.
13. Office of the Deputy Prime-Minister (2005). *A Practical Guide to the Strategic Environmental Assessment Directive, London, ODPM Publications*.
14. OECD (2006). *Applying Strategic Environmental Assessment: Good practice guidance for development co-operation, DAC Guidelines and Reference Series*.
15. PARTIDÁRIO, Maria do Rosário (2012). *Strategic Environmental Assessment Better Practice Guide: Methodological guidance for strategic thinking in SEA, Portuguese Environmental Agency & Redes Energéticas Nacionais (REN)*.
16. PINHEIRO, Manuel Duarte (2006). *Ambiente e construção sustentável, Amadora, Instituto do Ambiente*.
17. Regional Environmental Center for Central and Eastern Europe (2003). *EIA training resource manual for South Eastern Europe, Szentendre, REC*
18. Regional Environmental Centre (1996). *Awakening Participation: Building Capacity for Public Participation In Environmental Decision making, Szentendre, REC*.

19. SADLER, B. (2011). Taking stock of SEA, In: SADLER, B., ASCHEMANN, R., DUSIK, J., FISCHER, T.B., PARTIDARIO, M., VERHEEM, R. (eds), *Handbook of strategic environmental assessment, London, Earthscan.*
20. SADLER, B. and R. VERHEEM (1996). *Strategic Environmental Assessment, Volume 53: Status, Challenges and Future Directions, Ministry of Housing, Spatial Planning and the Environment, The Netherlands, and the International Study of Effectiveness of Environmental Assessment.*
21. THERIVEL, R. (2004). *Strategic Environmental Assessment in action, Earthscan, London.*
22. UN Habitat (2014). *Udhëzuesi për Vlerësimin Strategjik të Planeve Hapësinore, Programi për Mbështetjen e Planifikimit Hapësinorë Komunal në Kosovë, mbështetur nga SIDA*
23. UNEP (2014). *Integrating ecosystem services in Strategic Environmental Assessment: A guide for practitioners, A report of Proecoserv. Geneletti, D.*
24. UNEP (2009). *Integrated Assessment for Mainstreaming Sustainability into Policymaking: A Guidance Manual.*
25. VERHEEM, R. (1996). *Handbook of strategic environmental assessment, London, Earthscan.*

